


MBROJTËSI

Vëllimi IV - Nr. 3 ... drejtësi për të gjithë

www.kosovopolice.com
info@kosovopolice.com



NJËSITI I PARË NDËRHYRËS I SHPK-së

DEMONSTRON GATISHMËRI



Rruga drejt integriteteve

Më 15 qershor të këtij viti shteti i Kosovës do të ketë edhe Kushtetutën. Institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare janë duke bërë përgatitjet e nevojshme për datën e 15 qershorit. Natyrisht se procese të mëdha dhe historike siç është kjo datë kur Kushtetuta e Republikës së Kosovës pritet të hyjë në fuqi, nuk mund të kalojnë pa përgatitjet paraprake e që në këtë rast prekin edhe fushën e sigurisë. Në takimin e radhës në mes policisë dhe kryetarëve të komunave të Kosovës, një ndër pikat e rëndësishme të diskutimeve ishte edhe sfidat që mund të paraqiten gjatë fillimit të zbatimit të Kushtetutës së Kosovës. Edhe kolegët tanë me siguri se janë duke pritur fillimin e implementimit të saj dhe ndryshimeve pozitive që pritet të sjellë në shumë fusha të jetës dhe të punës. Fillimi i zbatimit të Kushtetutës është hap i rëndësishëm për të gjitha institucionet kosovare për rrugëtimin drejt integriteteve evropiane.

Në nenin 128 të Kushtetutës, që i dedikohet Policisë së Kosovës, është e cekur se "Policia e Republikës së Kosovës ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës, me stacione policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë."

Aty është e cekur edhe përgjegjësia për kontrollin e kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare. Mirëpo, të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me policinë në aspektin ligjor pritet të mbulohen nga "Ligji për policinë" që pritet të hyjë në fuqi së shpejti pas fillimit të zbatimit të Kushtetutës.

E tërë kjo është një arritje shumë e madhe por edhe një testim për aftësinë dhe përgjegjësinë e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë.

Çështje që do të diskutohen shumë gjatë ditëve në vijim me siguri se do të jenë çështja e procesit të rikonfigurimit të policisë së UNMIK-ut dhe ajo rreth misionit të Bashkimit Evropian në sundimin e ligjit në Kosovë

– misionit të EULEX-it.

SHPK vazhdon të mbajë takimet me përfaqësuesit e misionit të ardhshëm të EULEX-it. Policia e BE-së, në misionin e ardhshëm, në pjesën më të madhe të punës së saj do të monitoroj, udhëzoj dhe këshilloj SHPK-në në të gjitha fushat e veprimtarisë policore.

Pavarësisht nga zhvillimet politike dhe situatave të ndryshme që mund të paraqiten në teren si rezultat i këtyre zhvillimeve, policia do të vazhdojë të përm-bushë detyrat e saj në përputhje me misionin dhe vizionin e saj.

Shumë prej temave të trajtuara në këtë numër flasin pikërisht për aktivitetet e përditshme të SHPK-së në luftën kundër krimit duke mbrojtur në këtë mënyrë jetën dhe pronën e qytetarëve kosovar.

Falënderim

Sindikata e SHPK-së falënderon KFOR-in Italian për ndihmën e ofruar

Oficerja e sigurimit të SHPK-së, Vahide Lajqi në bashkëpunim me SSHPK-në, gjeti mbështetje të KFORi Italian për dërgimin e djalit të saj, Florianit 7 vjeçar (që vuan nga sëmundja e Leukimisë) për shërim në Piza të Italisë. Djaloshi u dërgua për shërim nën përcjellje me të ëmën dhe të gjitha shpenzimet përkitazi me shërimin e Florianit i mori përsipër KFOR-i Italian.

Sindikata e SHPK-së, po ashtu, përmes KFOR-it Italian, është duke bërë përpjekje që të dërgoj për shërim në Itali, në Torino, fëmijën dymbëdhjetë vjeçar të policit të SHPK-së - S. Nurkoviç për operim në zemër. Fëmija nën përcjellje të së ëmës, pritet të udhëtoj për në Itali në qershor. Edhe për këtë rast, të gjitha shpenzimet përkitazi me shërimin mori përsipër KFOR-i Italian.

Falënderojmë KFOR-in Italian për ndihmën e ofruar.

Fjala e urtë e zgjedhur për këtë numër

"Ne bëhemi të drejtë duke bërë veprime të drejta, të përmbajtur duke bërë veprime të përmbajtura, të guximshëm duke bërë veprime të guximshme." Aristoteli , 384-322 BC



Buletini informativ i policisë në Kosovë është botim i SHPK-së dhe policisë së UNMIK-ut.

Botues

Njësiti i Redaksisë,
Zyra e Komisarit për Media,
SHP i Policisë, Prishtinë

Redaktor

Arbër Beka
VSAT: 2699
Tel.: 038 5080 1237
Mob.: 044 146 696
arber.beka@kosovopolicice.com
arberbeka@gmail.com
revistambrojttesi@kosovopolicice.com

Fotograf


SERHAT ALKAN
VSAT: 2323
Mob.: 044 416 106

Disajner

Çajup Kajtazi
Bashkim Përçuku
VSAT: 1046/1145
Mob.: 044 315 985
049 300 005
çajup.kajtazi@kosovopolicice.com
bashkim.përçuku@kosovopolicice.com

Asistentët e Redaktorit

Drin Gjonbalaj
Renata Marijanac



MBROJTËSI QERSHOR 2008

2 INTERVISTË

Laboratori i kriminalistikës
Vendi ku zbulohet dhe luftohet krimi

7 SHPK

Sindikata e Shërbimit Policor
të Kosovës parashtrori kërkesat urgjente

8 1 QERSHORI

SHPK-ja shënon 1 Qershorin
Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve

10 NJPN

Njësiti i Parë Ndërhryrës
demonstron gatishmëri

13 VENDIMI I MPB-së

Vazhdohet suspendimi
me pagesë për oficerët
e suspenduar të SHPK-së

14 SIGURI

Armët nën kontroll
Fushata të flasin hapur

16 LAJME NGA RAJONI

Të fokusuar në punë ekipore
dhe bashkëpunim të mirë me qytetarë

20 SHKRIMI I ZGJEDHUR

Siguria nuk është vetëm
detyrë e policisë

22 GJERMANI

Dita e dritave
Të kaltra në krefeld

25 FOTOLAJME

ME GJERSISHT →

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të UNMIK-ut dhe SHPK-së



LABORATORI I KRIMINALISTIKËS

Vendi ku zbulohet dhe luftohet krimi

Qeveria Amerikane përkatësisht ICITAP-i para 8 vitesh kishte vendosur që të ndihmonte Kosovën në zhvillimin e Forenzikës. Ishte Z. Richard Tanton ai i cili ishte ngarkuar me koordinimin dhe menaxhimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për Kosovën.

Në javën e parë të majit, Ambasadorja amerikane në Prishtinë - Tina Kaidanow, i ka dorëzuar ministrit të Punëve të Brendshme të Qeverisë së Kosovës, Zenun Pajazitit, çelësat e laboratorit të forenzikës që do t'i shërbejë policisë kosovare.

Përveç 10 milion dollarëve të investuar deri më tani, ambasadorja Kaidanow ka premtuar se ndihma amerikane do të vazhdojë edhe më tutje për

laboratorin e forenzikës, të cilit do t'i sigurojë një këshilltar, për të siguruar kontroll të vazhdueshëm të cilësisë. Qeveria amerikane, po ashtu do të jetë e përfshirë në një projekt shumëvjeçar për t'i ndihmuar laboratorit që të fitoj akreditim ndërkombëtar.

"Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i dhuron Kosovës një laborator të plotë të forenzikës, të kompletuar me teknologjinë më të re dhe me një personel të trajnuar shumë mirë", ka thënë Kaidanow në ceremoninë e pranimit të dorëzimit të laboratorit.

Laboratori i forenzikës kishte filluar të ndërtohet në vitin 2001, për tu përfunduar tri vite më vonë.

Kostoja e ndërtimit kishte arritur vlerën prej 7 milion dollarëve, ndërkaq vlerësohet të jetë njëri nga laboratorët policorë më të pajisur në rajon.

Në këtë laborator mund të kryhen analizat në pesë fusha kryesore – kimia e drogave, ekzaminimi i armëve të zjarrit, ekzaminimi i gjurmëve të gishtave, analiza e dokumenteve dhe analizat e gjakut dhe ADN-së.

“Qeveria e SHBA-ve ka investuar 750 mijë dollarë për të pajisur laboratorin dhe 2,5 milion dollarë shtesë për trajnim dhe personel, që në total arrijnë një shumë prej 10 milion dollarësh”, ka thënë znj. Kaidanow.

Sipas saj, ky laborator i forenzikës përmirëson kapacitetin hetimor të Kosovës në mënyrë të jashtëzakonshme dhe i mundëson SHPK-së të kryej analizën forenzike këtu e jo ti bart dëshmitë diku tjetër që do të ishte e kushtueshme dhe jo efikase.

“Duke iu falënderuar punës së laboratorit dhe personelit të tij, në shumë nga këto raste, të dyshuarit janë arrestuar dhe me sukses janë ndjekur penalisht”, ka thënë Kaidanow.

Dorëzimin e laboratorit të forenzikës në menaxhim të plotë të SHPK-së, ministri Pajaziti e sheh si dëshmi se policia kosovare po i ngrit kapacitet në luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit.

“Ne jemi të përkushtuar të jemi në nivel të lartë të detyrës që të sigurojmë sundimin e ligjit. Në këtë kontekst ne jemi të vendosur të ndjekim një qasje pro-aktive duke dëshmuar lidhshirë dhe pronësi të plotë në sektorin e sundimit të ligjit gjithnjë në bashkëpunim me faktorët relevant vendor dhe ndërkombëtar”, ka thënë ministri Pajaziti.

Dorëzimi i laboratorit në duart e SHPK-së nuk do të thotë se qeveria amerikane nuk do të vazhdojë të angazhohet edhe në të ardhmen për të.

“Përveç, ofrimit të trajnimit në fushat e specializuara, siç është analiza e ADN, Departamenti i Drejtësisë do të sigurojë edhe një këshilltar, për të siguruar kontroll të vazhdueshëm të cilësisë. SHBA-të janë të përfshira në një projekt shumëvjeçar për t’i ndihmuar laboratorit që të fitoj akreditim ndërkombëtar, me një çmim shtesë prej gjysmë milioni dollarë”, ka premtuar ambasadorja Kaidanow.

QEVERIA AMERIKANE I DORËZON NË MENAXHIM SHPK-së LABORATORIN E KRIMINALISTIKËS



Për të marrë më shumë informata rreth funksionimit të këtij laborator modern, ekipi i Mbrojtësit intervistoi drejtorin e këtij laborator – nënkolonel Blerim Ollurin.

Ai shpjegoi se aty punon një staf prej 40 zyrtarësh të cilët janë të trajnuar, të kualifikuar dhe specializuar për të ofruar këto shërbime forenzike.

“Në këtë laborator ne kryejmë ekspertime kriminale të substancave narkotike, të dokumenteve të dyshimta (si bankënota, pasaporta, patentëshoferë, viza etj), pastaj ekspertime grafologjike të nënshkrimeve dhe dorëshkrimeve, teste balistike të armëve të zjarrit dhe gjurmëve të veglave, ekspertime të gjurmëve të gishtave (vijave papilare), përgatitje dhe dorëzim të mostrave të ndryshme në Kroaci për analizë dhe anasjelltas etj” – theksoi nënkolonel Olluri.

Ai shtoi se këtë vit për herë të parë në Kosovë ata do të fillojnë edhe me analiza të ADN-së:

“Falë teknologjisë bashkëkohore dhe punës së palodhshme të ekspertëve me një mesatare vjetore prej 2280 ekspertizash, bëhen shumë identifikime të kryerësve të veprave penale. Vetëm në tremujorin e parë të këtij viti kemi identifikuar (zbuluar) 30 kryerës të veprave të ndryshme penale. Një lajm i mirë për të gjithë

oficerët dhe qytetarët e Kosovës me siguri është se këtë vit do të fillojmë të bëjmë këtu edhe analizat e ADN-së” – potencoi drejtori i laboratorit të SHPK-së.

Në kuadër të programit/mbështetjes nga Qeveria Amerikane është edhe zhvillimi i kapaciteteve të zyrtarëve që punojnë aty për analiza të ADN-së. Në kuadër të këtij programi ICITAP-it do të vazhdojë me trajnimin e ekspertëve të ADN-së në Gusht 2008 dhe pritet që deri në fund të këtij viti të funksionojë në tërësi sektori i ADN-së dhe për herë të parë në Kosovë të kryhen analizat e ADN-së.

Një ndër objektivat kryesore të laboratorit të SHPK-së sipas Ollurit është që të realizojë akreditimin sipas ISO 17025 sepse me këtë do të rritej kualiteti i shërbimeve forenzike, do të rritej besueshmëria e rezultateve forenzike, do të mundësohej anëtarësimi në ENFSI-i dhe do të mundësohej ofrimi i shërbimeve forenzike dhe bashkëpunimit për shtetet fqinje.

“Procesi i akreditimit të laboratorit sipas ISO 17025 është në vazhdim e sipër dhe janë vendosur shumica e parakushteve për akreditim. Ne kemi përmbyshur pothuajse të gjitha parakushtet si: Procedurat Standarde të Operimit të cilat zbatohen, kemi bërë testet e aftë-





sive profesionale, pastaj kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe instrumenteve, vlerësimi i Ekspertëve në Seanca Gjyqësore, kushtet dhe ambienti i punës, manovrimi i artikujve të dëshmvive etj” – theksoi nënkolonel Olluri.

Në Mars të këtij viti ky laborator ka aplikuar për anëtarësim në ENFSI (Asociacioni Evropian i Instituteve të Shkencës së Forenzikës) ku një aplikim i tillë është mirëpritur nga Bordi i ENFSI-it. Zyrtarët që punojnë aty planifikojnë që deri në vitin 2010, laboratori të akreditohet në tërësi sipas ISO 17025.

Krahas sukseseve nënkolonel Olluri ceku edhe sfidat që ata ballafaqohen :

“Një ndër sfidat me të cilat jemi ballafaquar që nga themelimi është humbja e stafit të kualifikuar si rezultat i pagave të vogla. Është mëse e qartë se një ekspert me një kualifikim dhe përgatitje





të lartë shkollore e ka shumë të vështirë të kryej punën me një pagë pak mbi 200 EURO, kur dihet mirëfilli se përgjegjësia e lartë në kryerjen e kësaj pune e sidomos në mbrojtjen e lëndëve me peshë të rëndë të përgjegjësisë.”

Nnëkolonel Blerim Olluri shpreh opinionin se stafi i Labororit Qendror të Kriminalistikës duhet të ketë tretman të veçantë për shkak të përgjegjësisë së lartë, ndjeshmërisë së punës, rrezikut të mundshëm nga kriminelët, rrezikut nga infektimet me materie kimike, bakteriologjike

apo rreziqe të tjera gjatë punës.

“ Kjo do t’i ndihmonte Labororit që të ketë më të lehtë arritjen e akreditimit sipas ISO 17025 dhe anëtarësimit në ENFSI, gjë që do të rriste kualitetin e ekspertizave dhe do të ndikonte pozitivisht në ruajtjen e stafit të vyeshëm dhe deficitarë”- theksoi ai në fund të intervistës.



Sindikata e Shërbimit Policor të Kosovës parashtroi kërkesat urgjente

Sindikata e Shërbimit Policor të Kosovës që nga themelimi i saj identifikoi çështjet prioritare

jetike për pjesëtarët e Shërbimit, të cilat tashmë u janë të njohura të gjitha institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, por edhe gjithë opinionit kosovar. Ata disa herë adresuan kërkesat e tyre për zgjedhjen e disa problemeve sa i përket kushteve të punës dhe mirëqenies së oficerëve të SHPK-së.

“Parashtruar kërkesa për zgjidhjen urgjente të tyre, kërkesa këto që hasën dhe po hasin në vesh të shurdhër, ndërsa pjesëtarët e këtij Shërbimi që nga themelimi përballen me sakrifica dhe rrezikshmëri të lartë. Nëntë vite kaluan, gjithnjë duke shpresuar se çështjet jetike do ti zgjidhin institucionet tona demokratike. Nëntë vite, pjesëtarët e këtij Shërbimi u ofrojnë qytetarëve siguri dhe rend, duke sakrifikuar edhe jetën e tyre. Dhjetë nga ta kanë rënë në krye të detyrës, duke kryer me nder misionin fisnik, ndërsa ky Shërbim është i vetmi në botë që nuk gëzon sigurimin shëndetësor. Këtë tashmë e din e të gjithë. Institucionet kompetente për zgjidhjen e kësaj çështje, në vend që urgjentisht ta zgjidhin këtë, ato heshtin” – thuhet në kërkesën e radhës nga SSHPK-ja.



“Ne shumë herë deri më tash apeluar që këto çështje dhe çështjet tjera jetike për pjesëtarët e këtij Shërbimi (sigurimi shëndetësor për pjesëtarët e SHPK-së, ngritja e pagës për të gjithë pjesëtarët e Shërbimit për të cilët as njëherë nuk ka pas ngritje, sigurimi i shujtës për pjesëtarët e Shërbimit, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit/sigurimi i transportit dhe pagesa e rrezikshmërisë dhe punës jashtë orarit për pjesëtarët e këtij Shërbimi) urgjentisht të zgjidhen, mirëpo, përgjigje nuk morëm.”

“Gjatë bisedave që zhvilluam në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht nga kompetentët e kësaj Ministrie na është premtua se këto çështje do të zgjidhen me fillimin e implementimit të Ligjit të Policisë. Ne kërkuam që beneficinet nga Projekt Ligji i Policisë të fillojnë së zbatuari menjëherë, mirëpo, kjo nuk po ndodh. Nuk kërkojmë as më pak e as më shumë se ç thuhet në Ligjin e

Policisë” – thuhej më tutje në këtë kërkesë duk cituar edhe nenin 60 të projekt-ligjit të Policisë të Republikës së Kosovës që ka të bëjë me “Kompensimi dhe paga për zyrtarët policorë”.

SSHPK-ja kërkuar që kompetentët nga MPB dhe Policia e Kosovës ti hartojnë dhe të jenë të gatshme të gjitha aktet nënligjore të domosdoshme për aplikimin e beneficioneve nga Projekt Ligji i Policisë, që nga data e hyrjes në fuqi.

SSHPK-ja kohë më parë kishin tërhequr vërejtjen se “pjesëtarët e këtij Shërbimi tashmë janë kategori të rrezikuara sociale, duke pas parasysh se artikujt e domosdoshëm elementar janë shtrenjtuar qind për qind e në disa raste edhe më shumë” kurse nuk ka pasur lëvizje në paga.

“Jo me vullnetin dhe dëshirën tonë, tërheqim vërejtjen, se po që se nuk fillohet me implementimin në tërësi të beneficioneve nga ligji, Sindikata e SHPK-së do të ngrit Këshillin

Organizativ për organizimin e protestave të mundshme. Shpresojmë se kompetentët do ta kenë këtë parasysh dhe se me kohë do të fillojnë implementimin e ligjit dhe beneficioneve në tërësi të parapara me këtë ligj.” – thuhej në fund të kërkesës nga Kryesia Qendrore e Sindikatës të SHPK-së.

Me rastin e ditës ndërkombëtare të fëmijëve, SHPK-ja në Obiliq organizoi kampin veror multi-etnik në Brezovicë, kurse në Malishevë edukoi të rinjtë për sigurinë e trafikut rrugor



SHPK-ja SHËNON 1 QERSHORIN DITËN NDËRKOMBËTARE TË FËMIJËVE

Ajo se me çfarë mburret Kosova është rinia e saj. Duke pasur parasysh përqindjen e të rinjve nga numri i përgjithshëm i popullsisë del se populli i Kosovës është një ndër më të rinjtë në Evropë. Natyrisht se policia vendore i kushton një rëndësi të madhe edukimit të rinisë kosovare në shumë çështje që ndërlidhen me fushën e sigurisë individuale dhe më gjerë. Aktivitetet e SHPK-së me të rinjtë shtrihen në fusha e në forma të ndryshme. Zyrtarët policor u përkujdesën që edhe me rastin e ditës ndërkombëtare të

fëmijëve të ketë organizime dhe aktivitete të ndryshme.

Kështu, zyrtarët e SHPK-së nga stacioni policor i Obiliqit në bashkëpunim edhe me grupet punuese në nivel komunal organizuan një kamp veror ku morën pjesë 45 nxënës të klasave të shtata dhe të teta nga shkollat fillore të Komunës së Obiliqit. Prej nxënësve pjesëmarrës të komuniteteve multi-etnike 25 nxënës janë shqiptar, 12 prej tyre Serb, 2 Boshnjak, 3 Rom dhe 3 Ashkali.

Ky projekt i policisë në bashkësi të stacionit policor të Obiliqit ka si



qëllim shënimin e Ditës ndërkombëtare të fëmijëve, pastaj bashkëpunimin dhe shoqërimin mes 45 të rinjve gjatë zhvillimit të 4 punëtorive tematike, aktiviteteve sportive dhe argëtuese. Ky është viti i katërt me radhë që organizohet një kamp i tillë veror nga stacioni Policor i Obiliqit.

Me këtë kamp veror dëshirohet të dëshmohet se rinia kosovare mund të përmirësoj mënyrën e jetesës, komunikimin, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin duke marrë pjesë në mënyrë aktive në çështjet që janë dhe kanë të bëjnë me ta.

"Kampimi Multietnik Veror" që u organizua në "Parkun Nacional" në Brezovicë (hotel "MOLIKA") ishte 5 ditor me program të ngjeshur me katër punëtori. Në prezantime të ideve, mendimeve, punimeve dhe në përmbledhje të sugjerimeve, rekomandimeve të gjithë nxënësit u inkurajuan që të përfshihen në mënyrë aktive në të gjitha diskutimet. Temat, metodologjia e punës dhe aktivitetet sportive e argëtuese ishin planifikuar në atë mënyrë që të ndikojnë në kthimin dhe rritjen e besimit të ndërsjellët të nxënësit, me qëllim të zhvillimit të një shoqërie të shëndoshë. Në anën tjetër zyrtarët e SHPK-së përmes punëtorive të organizuara synonin edhe metodën preventive ndaj dukurive negative të shoqërisë. Temat të cilat u diskutuan

në këto punëtori kishin për qëllim ndikimin në ngritjen e nivelit të edukimit të rinisë kosovare ndaj shprehive të këqija si duhani, pastaj edukimin kundër përdorimit të substancave narkotike si dhe të sigurisë në trafik. Mirëpo ky nuk ishte organizimi i vetëm për ditën e fëmijëve. Zyrtarët e policisë së Kosovës në Malishevë ishin përkujdesur që të gjenin uniforma për "oficerët më të rinjë të SHPK-së" të cilët ndihmonin në rregullimin e trafikut në Malishevë.

E tërë kjo ishte e mirëpritur nga fëmijët të cilët me krenari bartnin uniformën e policisë së tyre duke bërë disa ndalje në trafik. Ata gjatë këtyre orëve sa qëndruan me oficerët e SHPK-së mësuan mjaft shumë edhe për rregullat e komunikacionit rrugor, për shenjat në trafik si dhe për shkaktarët e aksidenteve ku janë të përfshirë këmbësorët. Të gjitha këto aktivitete të SHPK-së dhe bashkëpunimi i tyre në projekte të ndryshme me të rinjtë kosovar tregon përkushtimin tonë për një rini të edukuar, të shëndoshë dhe të pasuruar me dituri të reja që në të ardhmen do të ndihmojnë dhe do të japin kontributin e tyre në përmbushjen e misionit policor për një shërbim që është i besuar nga popullata dhe është krenar për performancën e tij.



Me këto aktivitete dëshmohet se rinia kosovare mund të përmirësoj mënyrën e jetesës, komunikimin, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin duke marrë pjesë në mënyrë aktive në çështjet që janë dhe kanë të bëjnë me ta.





NJËSITI I PARË NDËRHYRËS DEMONSTRON GATISHMËRI

Niësi i Parë Ndërhyrës (NJPN-ja) është themeluar në vitin 2006 që t'i mbështesë njësitet tjera policore atëherë kur mundësitë e tyre vepruese tejkalohen. NJPN-ja përkrah kryesisht njësitet mbështetëse – në raste kur kemi të bëjmë me situata të cilat kategorizohen si shumë të rrezikshme. Nuk përjashtohet edhe ajo që në situata të rrezikshme NJPN-ja ti asistojë stacioneve

policore dhe rajoneve. Kjo njësi elite e SHPK-së, demonstroi para komandantit të KFOR-it Xavier De Marniac, Ministrit të Punëve të Brendshme-Zenun Pajazitit dhe zyrtarëve të lartë policor të SHPK-së se është e gatshme për reagime në situata të ndryshme që mund të paraqiten në teren. Në një rast të improvizuar NJPN-ja tregoi përgatitjen e tyre në lirin e pengjeve, pastaj taktikave të ndryshme të sulmit

dhe vetëmbrojtjes pastaj arrestimin e personave të cilësuar si të rrezikshëm dhe të armatosur në vendbanim etj.

NJPN-ja gjatë prezantimit të pajisjeve të tyre ceku edhe nevojën për pajisje shtesë si dhe për trajnime tjera në dhe jashtë Kosovës.

Ministri i Punëve të Brendshme Zenun Pajaziti, pasi uroi pjesëtarët e këtij njësi për demonstrimin e suksesshëm




ceku edhe angazhimet e MPB-së në përmirësimin e kushteve të punës për pjesëtarët e SHPK-së dhe njësiteve elite si NJPN-jatë: "MPB-ja ka kërkesa të shumta nga të gjitha fushat, por në fushën e sundimit të ligjit ne do të gjejmë mundësi që të bëjmë përmirësimin e kushteve të punës dhe trajnimeve të ndryshme. SHPK-ja ka bërë kërkesat e tyre dhe ne jemi duke punuar në realizimin e tyre" – theksoi ndër të tjerë Ministri Pajaziti. Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti theksoi rëndësinë e përgatitjeve profesionale të SHPK-së duke potencuar se policia e Kosovës do të vazhdojë përpjekjet për ngritjen e nivelit të përgatitjeve e në kuadër të kësaj





edhe të pajisjeve të nevojshme profesionale.

Edhe udhëheqësi i NJPN-së pas përfundimit të demonstrimeve theksoi se ky njësit shumë shpejt do të radhitet krahas njërive tjera elite në rajon dhe Evropë: "Me trajnimet dhe përgatitjet që jemi duke i bërë ne shkojmë drejt profesionalizmit. Ne kemi paraparë edhe trajnime të tjera si brenda ashtu edhe jashtë vendit dhe besoj se NJPN-ja shumë shpejt do të radhitet krahas njërive tjera elite në rajon dhe më gjerë." – theksoi udhëheqësi i NJPN-së.



Vazhdohet suspendimi me pagesë për oficerët e suspenduar të SHPK-së

Vendimi i ri nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme:

Vazhdohet suspendimi me pagesë për oficerët e suspenduar të SHPK-së

Pas realitetit të ri politik të krijuar në Kosovë, një numër i pjesëtarëve të SHPK-së të komunitetit serb (rajoni i Prishtinës dhe ai i Gjilanit) deklaruan se nuk do të pranojnë urdhra nga SHPK-ja por vetëm nga policia e UNMIK-ut. Rreth 300 oficerë të SHPK-së të nacionalitetit serb u suspenduan me pagesë sepse ata refuzuan të respektojnë zinxhirin komandues të SHPK-së. Hetimet për këta oficerë të suspenduar është duke i udhëhequr Inspektorati Policor i Kosovës.

Rekomandimi i Inspektoratit Policor në rastin e kolegëve tonë serb ishte që suspendimi me pagesë të ndërpritet. Derisa ky rekomandim pritej të fuqizohej të gjithë kolegët ishin urdhëruar që të paraqiten në punë deri më 30.05.2008.

Ministria e Punëve të Brendshme mori vendim që kolegëve tonë serb t'u vazhdohet suspendimi me pagesë, ndërsa ky vendim është përkrahur edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

SHPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut është konsultuar nga Ministri Pajaziti dhe ne së bashku janë në përkrahje të procesit pozitiv të kthimit të kolegëve tonë në vendet e tyre të punës.

Me qëllim të ngritjes dhe avancimit të mëtutjeshëm të Policisë së Kosovës gjithnjë duke siguruar Shërbim

Policor shumetnik dhe në pajtueshmëri me praktikat më të avancuara ndërkombëtare;

"Duke marrë për bazë situatën e krijuar dhe disponimin gjithnjë në rritje të pjesëtarëve të suspenduar të SHPK-së për kthim në vendet e tyre të punës, Ministria e Punëve të Brendshme me mbështetje të Qeverisë dhe në koordinim të plotë me UNMIK-un dhe të gjithë mekanizmat relevantë ndërkombëtarë në Republikën e Kosovës ka vendosur për ta shtyrë afatin e suspendimit me pagesë të pjesëtarëve të SHPK-së nga radhët e Komunitetit serb"- thuhej në njoftimin zyrtar të MPB-së.

" Ne jemi të vetëdijshëm për faktin se pjesëtarët e SHPK-së nga radhët e komunitetit Serb janë duke u ballafaquar me presion nga Qeveria e Beogradit dhe disa liderë politikë dhe religjioz këtu në Kosovë. Pozicioni ynë është shumë i çartë. Policët e suspenduar janë pjesë e Institucioneve shtetërore të Kosovës dhe ne kemi përgjegjësi për t'i mbrojtur dhe përkrahur ata. Në këtë frymë, ne do të bëjmë gjithçka që është në mundësinë tonë për t'i përkrahur ata që ta tejkalojmë këtë gjendje. Në këtë kontekst ftojmë të gjithë parterët relevantë ndërkombëtarë që të vazhdojnë të inkurajojnë pjesëtarët serb të SHPK-së që të kthehen në vendet e tyre të punës dhe të kontribuojnë në krijimin e një ambienti të qetë dhe sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës"- thuhej në fund të njoftimit nga MPB-ja. Ky vendim do të mbes i plotfuqishëm deri në vendimin tjetër nga MPB-ja ose Qeveria e Kosovës.

Armët nën kontroll Fushata të flasim hapur

Në Kosovë shënohet Java globale e veprimit kundër dhunës me armë, me qëllim të ngritjes së shkallës së vetëdijesimit të qytetarëve. Kjo fushatë është pjesë e javës kundër dhunës me armë, e cila shënohet në tërë botën me një përpjekje për të vënë nën kontroll armët e vogla dhe për të ulur shkallën e rrezikut që vije prej tyre.

Gjatë vitit 2007 në Kosovë, policia ka raportuar për një numër më të madh se 1700 raste të krimeve që lidhen me armë, në një Kosovë e cila vlerësohet të ketë mbi 300 mijë armë të ndryshme, çështje kjo për të cilën do të avokohet gjatë javës globale kundër dhunës me armë, përmes një fushate të institucioneve të Kosovës, të mbështetur nga donatorë ndërkombëtarë dhe të drejtuar nga UNDP-ja, duke filluar nga data 2 deri më 9 qershor.

Kjo fushatë është pjesë e Projektit për armë të vogla, të financuar nga Britania e Madhe, Suedia, Holanda, Danimarka dhe nga UNDP-ja dhe është vetëm një pjesë e vogël e projektit të përgjithshëm, i cili mbështetet nga Shërbimi Policor i Kosovës përmes trajnimeve dhe pajisjeve, nga Qeveria e Kosovës përmes çështjeve që kanë të bëjnë me politikën dhe nga shoqëria civile përmes aktiviteteve të avokimit.

Përveç kësaj, një projekt i këtillë do t'i përkrahë institucionet e Kosovës për të zbatuar në nivelin lokal marrëveshjen ndërkombëtare të quajtur "Programi i Kombeve të Bashkuara për parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e tregtisë së paligjshme me armë të vogla dhe me armë të tjera, në të gjitha aspektet e saj."

Në aspektin global, mesatarisht çdo ditë vdesin nga një mijë njerëz si pasojë e të shtënave me armë, si dhe





një numër tri herë më i madh se ky plagosen rëndë. Palca të këputura kurrizore, eshtra të thërrmuara, familje të shkatërruara, zemra të thyera janë epilogu i këtyre të shtënave. Po të mund të kategorizoheshin si një sëmundje rastet e vdekjeve, të plagosjeve dhe të paaftësive të fituara nga këto të shtëna me armë, atëherë këtë lirisht do ta konsideronim si një epidemi. Si një virus i prodhuar nga vetë njeriu, i krijuar për të shkaktuar lëndime. Armët janë qartë të dëmshme për shëndetin e njeriut.

Asnjë shtet nuk është imun ndaj kësaj dukurie.

Edhe SHPK-ja ishte pjesë e aktiviteteve të kësaj jave globale pothuajse në të gjitha takimet dhe diskutimet që u bënë për këtë temë. Zyrtarë të SHPK-së falënderuan të gjithë ata që angazhohen në kontrollin e armëve:

“Këtë fushatë e shoh si një përpjekje për të vënë në kontroll armët e vogla dhe për të ulur shkallën e rrëzikut që vie prej tyre e që nuk është i vogël, prandaj përkushtimi ynë në këtë drejtim do të jetë maksimal”- theksoi Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti gjatë fjalimit të tij në kuadër të kësaj fushate. Ai potencoi rëndësinë e angazhimit të të gjithë faktorëve relevant përfshirë këtu edhe shoqërinë civile për të përmirësuar gjendjen dhe zvogëluar krimet që lidhen me armë.

“Kontrolli i armëve të vogla mund të jetë i suksesshëm nëse ne ndërtojmë një legjislacion të mirëfilltë, ndër-

tojmë një strategji të mirë për kontrollin e armëve, grumbullimin e armëve, pastaj nëse prandalojmë dhe zvogëlojmë krimin që rrjedh nga përdorimi i armëve të zjarrit, largimin e armëve ilegale në Kosovë, ndërprerjen e kanaleve të furnizimit të paligjshëm me armë, zvogëlimin e nevojave dhe kërkesave të shoqërisë për armë, pastraj krijimin e politikave të favorshme për kontrollin e armëve, ngritjen e kapaciteteve tona për të luftuar këtë dukuri etj” – theksoi Zv.Komisari i SHPK-së Sheremet Ahmeti duke i siguruar të pranishmit se SHPK-ja është e vendosur në përmushjen e misionit të saj në zbatimin e ligjit në Kosovë.

Për çdo vit, aktivistë dhe qeveri nga e mbarë bota e shfrytëzojnë këtë Javë globale të veprimit kundër dhunës me armë, me qëllim të ngritjes së shkallës së vetëdijesimit, ata kryejnë një fushatë për ligje më të mira për armë dhe japin një shtysë për rregullimin më të fuqishëm të tregtisë globale me armë. Këtë vit, Java e veprimit përfshin periudhën 2 deri më 9 qershor 2008. Në mënyrë globale, aktivistë nga tërë bota (vitin e kaluar ishin më shumë se 60 shtete anekënd rruzullit) do ta theksojnë dimensionin e çmimit të paguar në njerëz si pasojë e shtimit të numrit të armëve të vogla dhe të keqpërdorimit të tyre; këta aktivistë po ashtu do të kërkojnë nga qeveritë që të dekretojnë politika të tilla, të cilat sigurojnë e qytetarëve të tyre do ta vejnë në plan të parë.



STACIONI POLICOR I RAHAVECIT

Të fokusuar në punë ekipore dhe bashkëpunim të mirë me qytetarë

Aty, rrëzë bjeshkëve të Zatriqit dhe Anadrinit, në anë tjetër shtrihet qyteza e Rahavecit, qytezë shumë e vjetër dhe e njohur edhe më tej Kosove për kultivimin e hardhisë së rrushit dhe verës cilësore e cila prodhohet nga banorët e vyer të kësaj ane.

Këtë herë nuk do të shkruajmë për rrushin e Rahavecit dhe verën cilësore dhe as për "Divanin" e Sheh Malës i njohur si vepra e parë e të folmes së Rahavecit, por, do të përpiqemi që me pak fjalë të japim një portret të stacionit të Rahavecit dhe

njësitit të hetimeve të krimit në këtë stacion.

Arsyeja për këtë shkrim ishte një takim që zuri vend në lokalet e Stacionit policor në Rahavec me eprorë të SHPK-së nga rajoni i Rahavecit ku morën pjesë edhe policët hetues Hamit Morina dhe Reshat Kabashi. Në këtë takim nënkolonel Faton Alia i përgëzoi hetuesit për punën dhe suksesin e arritur në zbulimin e disa rasteve kriminale, ai i përgëzoi edhe njësitet e tjera për angazhimet e tyre të përditshme në drejtim të zbatimit të ligjit aty.





Sipas statistikave del se një numër i konsiderueshëm i rasteve janë zgjidhur me kryerës dhe janë dërguar në organe të drejtësisë. Këta oficerë hetues së bashku me kolegët e tyre ballafaqohen me sfidat e përditshme në luftën e SHPK-së ndaj krimit. Ata cekën se bashkëpunimi me qytetarë dhe puna ekipore është ajo çfarë u ndihmon në zgjidhjen e rasteve të ndryshme:

“ Ne kemi një bashkëpunim të mirë me kolegë dhe gjithmonë punojmë si ekip. Në anën tjetër në punë tonë na ndihmon edhe bashkëpunimi i mirë me qytetarët.”- theksoi për Mbrojtësin hetuesi Hamit Morina.

Që të dy ata u pajtuan se marrëdhëniet polici – publik sot paraqesin rëndësi të dorës së parë e

cila çon në drejtim të vendosjes së besueshmërisë dhe kuptimit në mes policisë dhe komunitetit. Në të njëjtën kohë, opinionin publik pret nga policia që duke respektuar principet e demokracisë, me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjatë zbatimit të operacioneve policore prioritet do ti ipet aspektit të preventivës, gjë që jep mundësi të duhura për iniciativat e reja reciproke në mes policisë dhe publikut.

Edhe kolegët nga Rahaveci janë shumë të fokusuar në marrëdhëniet në mes policisë dhe komunitetit si një parim i rëndësishëm i funksionimit të policisë në një shtet demokratik.

Nga Toger Hazir Berisha



“NE NUK DUHET T’I NDALOJMË FJALËT, PO KRIMIN!”

Qershori i vitit 1999 ishte muaji kur qytetarët e Kosovës më në fund morën lirshëm frymë thellë dhe u çliruan nga ankthi i pritjes së vdekjes. Njerëzit që ishin detyruar të gëzoheshin një dite jete më shumë nga kërcënimi i vdekjes, tani i gëzoheshin viteve që po vinin. Megjithatë liria e fituar nuk i kishte mbyllur të gjitha plagët. Dramat e familjeve po vazhdonin për shkak të mijëra njerëzve të zhdukur anekënd Kosovës, fatet e të cilëve ishin të pasigurta. Edhe frika nga hakmarrja ishte e madhe. Për më keq, një numër i njerëzve ishin të traumatizuar dhe të papërgjegjshëm në veprimet e tyre. Pikërisht në këtë kohë po ndodhte

demilitarizimi i UÇK-së. Kosova ende nuk e kishte Policinë e vet, për t’i mbrojtur qytetarët e lodhur nga lufta dhe pasiguria. Krijimi i policisë ishte bërë tashmë kërkesë e zëshme. “Dora e huaj nuk të kruan si e jotja”, “Skutat e vendit i njeh ai që jeton në të”, “hilen të keqes ia di ai që e ka pasur atë pranë”, ishin zërat e njerëzve të shqetësuar. Këta zëra ishin pranuar si kërkesa nga misioni ndërkombëtarë dhe ishte marrë vendimi me kohë: Kosova duhet ta formojë menjëherë forcën e policisë. Në shtator të vitit 1999 OSBE-ja themeloi Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës. U shpallë konkursi për të gjithë ata që deshën të bëhen mbrojtës të rendit. Por, që të arrihej ky mision duheshin bërë





shumë përgatitje të nevojshme e elementare së pari. U shtrua nevoja e një arsimim themelor, mbi bazat e të cilit, do të ndërtohej Shërbimi Policor i Kosovës.

Me 6 shtator të vitit 1999, u hap Shkolla e Policisë, në Vushtri. Mësimet i filluan, fillimisht 176 oficer policor të cilët kaluan me sukses.



Në fakt, hedhja e kapelave në qiell ishte pak më shumë se sukses shkollë! Ishte mesazh për paqe në qiellin e kaltër të Atdheut tonë.

Ishte një njeri i përkushtuar e profesionist që e kishte marrë përsipër suksesin. Ai ishte Steve Bennett i emëruar nga OSBE-ja, Drejtor Departamenti për Edukim dhe Zhvillim Policor, në Kosovë. Ai ishte i qartë: "Do ta krijojmë një polici që do të jetë model për Ballkanin dhe Evropën Jug-lindore".

Shkolla kishte trajnime të bazuara në standarde akademike të cilat ishin të përcaktuara me ligj. Gjithçka ishte planifikuar! Do të shkohej hap pas hapi! Në fillim punët e lehta e pastaj sprovat e rënda!

Komunikacioni drejtohej nga alamet djemsh e vajzash të cilët nganjëherë edhe dëgjonin fjalë të ndryshme për shërbimin e tyre. Po atyre nuk ju bëhej vonë?! Ata e kishin misionin e tyre: do të bëheshin model për Evropën Juglindore. Është mision që ka sfidat e veta prandaj ata i thoshin njëri tjetrit: ne nuk duhet ti ndalojmë fjalët, po krimin.

Njerëzit mbetën pa fjalë, kur kjo

policia e re u ndesh me kriminelët! Në një fshat të Dardanës u përball krimi. Mbetën të vrarë dy polic. Radhët e njerëzve që kishin ardhur në nderim të tyre, nuk kishin fund. Njerëzit thanë fjalë lavdërimi për policinë e tyre!

Zyrtarët policor prapë nuk thanë gjë: po përballonin dhembjen për shokët e vrarë.

Ata po trajnoheshin për kohë të rënda! Për kohët kur krimi do të "çmendej".

Dhe kjo kohë erdhi!

Krimin të organizuar në grupe i erdhi radha. Por, në duart e kriminelëve po vetëtinin prangat! Njerëzit po çliroheshin nga frika se e keqja do t'i gjente edhe ata! Qytetarët tashmë e kishin SHPK-në e tyre, e cila po u ofronte siguri dhe po u garantonte paqen në Vendin e tyre! Kjo u dëshmuar edhe në ditën e madhe të Pavarësisë. Në operacionin e madh të sigurisë së Vendit në këtë ditë të madhe u dha edhe një provim: Siguria në Kosovë është e garantuar. Garantues janë pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës.

Nga Njomza Krasniqi



Siguria nuk është vetëm detyrë e policisë

Ata që nuk pyesin çka shteti ka bërë për ata, por çka ata mund të bëjnë për shtetin

Shërbimi Policor i Kosovës çdo herë e më shumë po konceptohet si institucion në shërbim të qytetarëve duke luajtur një rol të rëndësishëm në një shoqëri demokratike e moderne.

Roli i SHPK-së në shoqërinë tonë e cila ende ballafaqohet me probleme të shumta është shumë i rëndësishëm. Duke iu referuar natyrës së veçantë të punës, e veçmas duke qenë institucion i specializuar për garantim të sigurisë dhe rendit publik, SHPK nuk do të mund ta realizonte me sukses këtë mision pa angazhimin e faktorëve të tjerë të shumtë që ndikojnë në këtë proces.

Siguria nuk është vetëm detyrë e

policisë.

Për t'u arritur stabilitet në vend, kërkohet angazhim dhe siguria duhet të konceptohet si detyrim i të gjitha strukturave shoqërore e shtetërore. Përderisa siguria përmirëson mirëqenien qytetare, të gjithë e konsumojmë, prandaj duhet edhe ta "prodhojmë" atë. Në këtë kontekst duhet të jetë e qartë se rendi dhe siguria publike, parandalimi i kriminalitetit të organizuar, parandalimi vrasjeve, trafikut të qenieve njerëzore etj, janë detyrim e obligim i të gjithë qytetarëve të Kosovës, e para të gjithave është obligim i organeve qeverisëse të vendit. Besoj që të gjithë ne kemi dëgjuar për vendet më të zhvilluara,

shumë nesh kanë përvoja nga vendet perëndimore ku të gjithë aktetë pjesëmarrës adresojnë dhe ndërhyjnë në çështje që konsiderohen jo të ligjshme, duke qenë të vetëdijshëm që kjo është zgjidhja e duhur për stabilitetin dhe mirëqenien e tyre, si dhe duke qenë në dijeni që kjo është detyrim në çdo shoqëri të civilizuar.

Shërbimi Policor i Kosovës është e vetmja adresë ku qytetari kërkon siguri, i vetmi organ i specializuar që ka mision ligjor sigurinë. Pjesëtarët e SHPK-së po bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të arritur standardet e vendeve të zhvilluara, prandaj, për t'u arritur kjo kërkohet profesionalizëm.

Megjithatë, jo vetëm në aspektin teorik, kjo mbetet pa efekt praktik, nëse nuk mbështetet prej faktorëve të tjerë të nevojshëm.

Oficerëve të Shërbimit Policor duhet tu krijohet një pozitë e dinjitoze morale e materiale. Ata nuk duhen të "frikohen" se kriminelin i arrestuar ditë më parë me sakrificë e duke iu nënshtruar rreziqeve të larta, të nesërmen do t'iu kaloj përballë, ose edhe ta rrezikoj vendin e tyre të punës, si pasojë e mosfunksionimit të shtetit të së drejtës.

Në këtë këndvështrim shihet qartë nevoja e angazhimit dhe investimit shtetëror e shoqëror

në parandalimin e dukurive që janë pengesë për mirëqenie shoqërore e zhvillim shtetëror.

Duke iu referuar kësaj duhet të jemi të vetëdijshëm që SHPK-së i është dashur investim fuqishëm që të vazhdoj rrugëtimin drejt një policie demokratike e funksionale në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Pas 9 viteve konsideroj që në këtë kontekst ka pasur mjaft arritje dhe është bërë përparim i dukshëm në këtë drejtim. Por, të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se siguria në vend është primare për mirëqenien e qytetarëve dhe se ajo mund të arrihet vetëm me

angazhim të të gjithave institucioneve dhe qytetarëve të vendit.

Me gjithë sfidat dhe kushtet e vështira (pagat e oficerëve, mungesa e sigurimit për ta etj), Shërbimi Policor i Kosovës me korrektësi e përgjegjësi ka kryer detyrat e saj dhe ka realizuar misionin, duke dëshmuar integritet të lartë profesional. Pikërisht për këtë duhet që të jemi të motivuar të angazhohemi dhe investojmë për sigurinë dhe rendin publik.

Ta perceptojmë Shërbimin Policor të Kosovës si institucion në shërbim të popullit.

Nga Hamide Bajrami

KY SHKRIM ËSHTË ZGJEDHUR SI SHKRIMI MË I MIRË NGA BORDI TRE ANËTARËSH: KAPITEN LATIFE NEZIRI, TOGER BRAHIM SADRIU DHE BAHRI GASHI NGA STAFI CIVIL I SHPK-së





DITA E DRITAVE TË KALTRA NË KREFELD

Zyrtarët e SHPK-së vizitojnë kolegët e tyre në Krefeld - Republika NRW - Gjermani

Në shkrimet tona ne disa herë kemi cekur se bashkëpunimi është çelësi i suksesit. Në këtë shkrim flitet për bashkëpunimin në mes SHPK-së dhe kolegëve tanë nga Krefeldi në Gjermani.

Në maj të këtij viti një delegacion tre anëtarësh i zyrtarëve të SHPK-së kishte udhëtuar në drejtim të këtij qyteti të bukur dhe të pastër për të përcjellur organizimin e "Ditës së dritave të kaltra". Kjo vizitë një javore ishte mundësuar dhe financuar nga organizata e OSBE-së në Prishtinë.

Objekti kryesor i vizitës ishte që pjesëmarrësve të kësaj vizite studiuese ti dhuroj mundësinë e njohjes së drejtpërdrejt me institucionet dhe organizatat të cilat udhëheqin dhe implementojnë projekte të tilla.

Vizitën jonë filloi me takimin e zyrtarëve të Policisë në Krefeld, të cilët kanë diskutuar strategjinë në të cilën është fokusuar policia në partneritet me institucionet

tjera për të implementuar projektin "dita e dritave të kaltra".

Ata gjatë takimeve në detaje kanë shpjeguar dinamikën e organizimit të brendshëm, politikat e financimit të projektit dhe çështjet e organizimit në partneritet deri në zbatimin e projektit si dhe konceptin organizativ me mediat.

Derisa kolegu ynë nga policia e Krefeldit –z. Michael Freienstein (që muaj më herët kishte qëndruar në Kosovë) na shpjegonte dhe shoqëronte nga zyra në zyrë duke dhënë shpjegime për projektin, ne shkëmbenim ide me kolegët gjerman edhe rreth funksionimit të zyrës për informim publik, sektorit të preventivës si dhe për funksionimin e rrjetit të partneritetit në mes policisë dhe institucioneve tjera.

Në një takim me drejtorin e policisë së Krefeldit - z. Dieter Friedrich, duke na uruar mirëseardhje ai na shpjeg-

goi për këtë projekt që kishte filluar të organizohej qysh 5 vite më parë:

“Qysh në vitin e parë kjo iniciativë është pritur shumë mirë nga qytetarët andaj edhe ka lindur ideja që të vazhdohet edhe në vitet e ardhshme. Qëllimi është që qytetarët e Krefeldit ta ndiejnë veten të sigurt. Ne duhet ti themi popullit se profesionalizmi ynë është siguria e juaj” - theksoi z. Friedrich i cili numëronte ditët e fundit të punës para pensionimit në atë pozitë.

Dhe dita finale e “dritave të kaltra” erdhi. Tani ishte momenti i rezultateve të nëntë muaj punë dhe angazhime të policisë, zjarrfikësve, si dhe zyrtarëve të institucioneve tjera nga Krefeldi. Çdo gjë ishte e planifikuar në detaje dhe numri i qytetarëve që kishin ardhur të shihnin këtë ngjarje sa vinte e shtoej.

Në një vend të zgjedhur më herët, ku kishte mjaft hapësirë për “aksionet e policisë dhe zjarrfikësve” kishin ardhur rreth 30.000 qytetarë për të përcjellur këtë ngjarje. Ata dëgjonin me vëmendje moderatorin e policisë duke shikuar skenarët e përgatitur nga njësite të ndry-



Zyrtarët e ShPK-së me Drejtorin e Policisë së Krefeldit -z. Friedrich

shme të cilat përcilleshin me duartrokitje.

Deri në fund të këtij organizimi ne patëm rastin të shohim se si institucionet që bartin dritën e kaltër në veturat e tyre zyrtare po komunikojnë me qytetarët e Krefeldit. Fundi i këtij organizimi shënonte edhe përfundimin e vizitës sonë në Gjermani. Të nesërmen pasi që falënderuam kolegët tanë nga Gjermania për mikpritjen e tyre vazhduam rrugëtimin tonë për në atdhe. Me këtë vizitë, ne kishim kuptuar edhe më shumë për rolin dhe rëndësinë e qasjes në partneritet me të tjerët në ofrimin e shërbimeve sa më efektive ndaj qytetarëve.

Derisa aeroplani i kompanisë austriake fluturonte në qiellin e kaltër mbi malet e Kosovës, ne së bashku diskutonim për mundësitë e një organizimi të ngjashëm këtu.





MUAJI MAJ - MUAJ I SUKSESIT NË LUFTËN KUNDËR NARKOTIKËVE


NË DY RASTE TË NDARA KONFISKOHEN RRETH 25 KG NARKOTIKË NGA SHPK-JA

Krimi i organizuar padyshim se përbën rrezik permanent për demokracinë dhe funksionimin e shtetit të së drejtës si dhe ka ndikim edhe progresin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Luftimi i krimit të organizuar nga SHPK-ja është një sfidë që vazhdon të përcjellë institucionin tonë prej vitesh, por në anën tjetër as sukseset në luftimin e tij nuk mungojnë. Gjatë muajit maj, në dy raste të ndara hetuesit e SHPK-së arritën që të konfiskojnë rreth 25 kg substancë të dyshimtë narkotike.

Pas një hetimi mbi pesë mujor nga ana e Njësisë transkufitare të Policisë e cila vepron në kuadër të drejtoratit kundër

krimit të organizuar, në afërsi të Dheut të bardhë (vendkalimi kufitar Kosovë – Serbi, afër Bujanovcit) u ndaluan dy vetura me targa të shtetit Zvicëran. Arsyeja e ndaljes ishte dyshimi i bazuar se në vetura do të mund të ishte një sasi e substancës narkotike e llojit heroin. Pas ndalesës së tyre dhe pas kontrollimit të veturave nga ana e njësisë së specializuar të krim teknikës është gjetur një sasi prej 10kg substancë narkotike dhe e njëjta është konfiskuar si provë materiale. Lidhur me këtë rast me dyshimin për trafikim të substancave narkotike policia ka arrestuar pesë persona, ndërsa janë konfiskuar edhe të dy veturat në fjalë.

Në rastin tjetër, Njësi qendror për hetimin e Narkotikëve i cili vepron në kuadër të drejtoratit kundër krimit të organizuar, pas operacionit të zhvilluar në tri lokacione, në fshatin Zaskok, Komuna Ferizaj në një shtëpi private konfiskoi 14.980kg (rreth 15kg) substancë narkotike e dyshuar të jetë heroin. Gjatë këtij operacioni u arrestuan pesë persona, katër nga të cilët janë Kosovar/Shqiptar ndërsa njëri shtetas Turk.. Dyshohet se sasia e narkotikëve e cila është konfiskuar në këtë rast ka arritur në Kosovë nga Turqia dhe pas përzierjes e cila ishte planifikuar të bëhej në fshatin Zaskok, si destinim e kishte tregun zvicëran.



1

Foto tregon pamje nga takimi me Kryetarët e Komunave dhe Policisë në ndërtesën e Ministrisë së Shërbimeve Publike në Prishtinë. Si pikë e diskutimeve ishin edhe përgatitjet e komunave dhe policisë për sfidat që mund të paraqiten gjatë implementimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nëpër komuna, pastaj problemi dhe sfidat e luftimit të kontrabandës së mallrave në veri të Kosovës si dhe për probleme të tjera që ndërlidhen me fushën e sigurisë.

2

Fotoja tregona provat materiale të konfiskuara nga Policia Kufitare e SHPK-së. Tri bastisje rezultuan në zbulimin dhe konfiskimin e rreth 100 vulave të ndryshme, dokumente tjera të dyshuara si të falsifikuara si: diploma universitetesh, certifikata të ndryshme, pasaporta etj.

3

26 fëmijë të institucionit parashkollorë "Gëzimi Ynë" vizituan rajonin policisë në Prishtinë, qendrën regjionale të komunikimit dhe st. Qendra. Fëmijët patën rastin të shohin edhe një pjesë të shkurtër dokumentari për policinë, dhe të marrin përgjigje në pyetjet e tyre drejtuar oficerëve.

4

Fotot tregojnë pamje të garës me vetura "Rally Albania 2008". Motoçiklistët e SHPK-së që shihen në foto, nuk kanë marrë pjesë në gara, ata vetëm kanë bërë sigurimin e përcjelljes së garuesve. "Ndoshta se nuk kishin konkurrencë të denjë".





Fotot tregojnë pamje nga organizimi "Dita e dritave të kaltra" në Krefeld - Gjermani. (Veturat dhe uniformat që janë përdorur nga policia gjermane dekada më parë)



Presim shkrimet tuaja!

Në numrin e ardhshëm të revistës Mbrojtësi, shkrimi më i mirë në një temë të lirë që ka të bëjë me çështje policore (suksese, probleme, sfida, bashkëpunimi me qytetarë etj), do të shpërblehet me një aparat digjital i cili është donacion i Sindikatës së SHPK-së. Shkrimi duhet të jetë përafërsisht dy faqe dhe i përcjellur edhe me foto që ndërlidhen me shkrimin tuaj.

Të gjitha shkrimet mund ti dërgoni deri më 20 korrik 2008 nëpërmes email adresës : revistambrojtesi@kosovopolic.com ose mund ti dorëzoni në Zyrën për Informim Publik në Shtabin e Përgjithshëm të Policisë, zyra nr 1.

Presim shkrimet tuaja!

Shkrimi më i mirë do të zgjidhet nga komisioni tre anëtarësh i zgjedhur nga njësitë i redaksisë dhe do të publikohet në numrin e ardhshëm.